



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujor –Gusht 2007

Dështimi për të siguruar prezencën e të pandehurit në gjykim, paraqet shkelje të ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Misioni i OSBE-së në Kosovë, (OSBE) shprehë shqetësimin lidhur me rastet e monitoruara në të cilat gjykatat e kanë zhvilluar procedurën penale në mungesë të të pandehuri, duke bërë kështu shkelje të të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim si dhe të drejtës për mbrojtje.

E drejta e të akuzuarit për të qenë i pranishëm në gjykim ka rëndësi fundamentale për korrektësinë e procedurës. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKCP) parashikon që “[në përcaktimin për akuzë penale, të gjithë kanë të drejtë [...] të jenë të pranishëm gjatë procesit.”¹ Megjithëse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)² nuk përmend shprehimisht të drejtën e personit për të marrë pjesë në gjykimin e vet, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) thekson se ekzistenca e kësaj të drejte “manifestohet nga objekti dhe qëllimi i neni [neni 6] të marrë si tërësi.”³

Prania në procedurë është esenciale edhe për të drejtën e personit që të mbrohet vetë.⁴ Sipas GJEDNJ, neni 6 i KEDNJ-së “i garanton secilit person të akuzuar për vepër penale të drejtën që të mbrohet vetë,” “të merr në pyetje dëshmitarët”[...] dhe është vështirë të kuptohet se si mund t’i realizojë këto të drejta pa qenë prezent.”⁵

Këto parime gjithashtu janë përfshirë edhe në ligjin vendës. Sipas KPPPK-së⁶ (i pandehuri ka të drejtë ta mbrojë veten personalisht ose përmes ndihmës juridike që i ofrohet nga mbrojtësi sipas zgjidhjes së tij/saj)⁷.

Përkundër këtyre kërkesave ligjore të qarta, OSBE ka vërejtur raste kur organet gjyqësore kanë mbajtur shqyrtime penale në mungesë të të pandehurit.

Në një rast para Gjykatës për Kundërvajtje në Pejë/Peć, trembëdhjetë të pandehur ishin akuzuar për prishje të rendit dhe qetësisë publike.⁸ Në seancat e mbajtura më

¹ Neni 14(3)(d), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKCP), 16 dhjetor 1966.

² Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), 4 nëntor 1950.

³ *Brozicek kundër Italisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), 11152/84, aktgjykimi, i 19 dhjetori 1989, para. 45.

⁴ Shih: neni 6(3)(c), KEDNJ; dhe neni 14(3)(d), PNDKCP; dhe neni 12, Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës (KPPPK), shpallur në fuqi përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003.

⁵ *Colozza kundër Italisë*, GJEDNJ, 9024/80, aktgjykimi i datës 12 shkurt 1985, para. 27.

⁶ Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës (KPPPK), shpallur në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003.

⁷ Neni 12, KPPPK.

⁸ Neni 18(5) dhe neni 19(1), i Ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 13/81. Përkundër kualifikimit ligjor të veprës me ligj të vendit, kjo vepër mund të konsiderohet si “e natyrës penale” (shih *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, GJEDNJ, 5100/71., aktgjykimi i datës 8 qershor 1976, para. 82) ngase përmban ndalesë e cila vlen për të gjithë banorët dhe mund të rezultojë me dënim me burg deri në dy muaj (në fakt, njëri prej të pandehurve në fund ishte dënuar me 30 ditë burgim dhe një tjetër me 20 ditë burgim). Prandaj, personi i gjykuar për këtë vepër do të duhej të

18, 19, 21 dhe 26 qershor 2007, gjyqtari i kishte thirrur të pandehurit të deklarohen njëri pas tjetrit. Pastaj, nga të pandehurit të cilët nuk ishin të përfaqësuar me avokatë ishte kërkuar që të dalin nga zyra. Nga ky shkak asnjëri prej tyre nuk ishte i pranishëm kur u dëgjuan disa dëshmitarë. Kjo ishte kështu pjesërisht për shkak të faktit se zyra e gjyqtarit ishte aq e vogël sa vetëm katër persona tjerë përveç gjyqtarit mund të qëndronin aty në të njëjtën kohë.⁹

Dështimi i gjyqtarit për kundërvajtje që të sigurojë praninë e të pandehurve paraqet shkelje të të drejtave të tyre për gjykim të drejtë, dhe me këtë i ka parandaluar që ata ta ndjekin procedurën,¹⁰ paraqesin mbrojtjen e tyre dhe t'ju bëjnë pyetje dëshmitarëve.

Në një rast tjetër, me përfshirjen e disa vjedhjeve të supozuara¹¹ para Gjykatës Komonale në Prizren, më 22 nëntor 2006 dy të bashkakuzuar ishin sjellë para gjyqtarit të procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin.¹² Përafërsisht dhjetë minuta pasi kishte filluar dëgjimi, i bashkakuzuari i tretë ishte sjellë në gjykatore. Në vend që të fillohet sërish me dëgjimin, gjyqtari i procedurës paraprake vazhdoi me procedurën.

Në rastin e dytë, mungesa e njërit prej të akuzuarve në fillim të dëgjimit e ka parandaluar atë që të informohet mbi të drejtat e veta¹³ dhe akuzat kundër tij.¹⁴ Gjithashtu, mbrojtësi i tij nuk ka mundur t'i dëgjojë arsyet për caktimin e paraburgimit,¹⁵ dhe nga ky shkak nuk ishte në pozitë për ta mbrojtur si duhet klientin e vet.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon si në vijim:

- Gjyqtarët duhet të shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për të siguruar praninë e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale. Këto mjete do të duhej përfshirë: (a) seancat për caktimin e paraburgimit të mbahen nëpër salla të gjyqimit të madhësisë së përshtatshme; (b) shtyrjen e dëgjimeve nëse i pandehuri nuk është i pranishëm; dhe (c) rifillimi i dëgjimit në rastet kur një ose më shumë të pandehur paraqiten pasi të ketë filluar dëgjimi.

kishte garancitë e paraparë me nenin 6 të KEDNJ-së në procedurën për kundërvajtje (shih Shqyrtimin e sistemit të drejtësisë penale në Kosovë, të OSBE-së, dhjetor 2006, faqe 20-22).

⁹ Shënim: në kundërshtim me procesverbalin e gjyqimit, të pandehurit nuk ishin informuar lidhur me të drejtën e caktimit të avokatit. Kjo gjithashtu paraqet shkelje të PNDCP, sipas të cilës secili e ka të drejtën e mbrojtjes personalisht ose përmes ndihmës juridike të cilën ai/ajo e zgjedh [dhe] të drejtën e informimit mbi këto të drejta nëse ai/ajo nuk ka ndihmë juridike” (neni 14(3)(d), PNDCP).

¹⁰ Në mënyrë që i akuzuari të mund ta mbrojë veten, ai/ajo duhet të ketë të drejtë në “pjesëmarrje efektive” në gjykim (shih *Stanford kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, 16757/90, aktgjykimi i datës 23 shkurt 1994, para. 26).

¹¹ Neni 252, Kodi i përkohshëm penal i Kosovës (KPPK), shpallur në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25 për Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, 6 korrik 2003.

¹² Neni 282, KPPPK.

¹³ Shih nenin 282(2) dhe nenin 214(1), të KPPPK.

¹⁴ Shih nenin 214(1), nr 1 dhe nenin 282(5), të KPPPK.

¹⁵ Shih nenin 282(5), të KPPPK.

- Mbrojtësit, po qe se janë të pranishëm, duhet të kundërshtojnë seancën për caktimin e paraburgimit kur ajo mbahet në mungesë të klientëve të tyre dhe të kërkojnë nga gjyqtari që ta sigurojnë praninë e të pandehurit.
- Mbrojtësit, duhet të kundërshtojnë vendimet që janë marrë në shqyrtimet e zhvilluara pa praninë e të pandehurve, duke u mbështetur në bazat e përcaktuara me nenin 403(1) nr. 3, të KPPPK-së.

Caktimi i gabuar i vlerës së objektit të çështjes kontestuese, ndikon në të drejtën për gjykim nga tribunali i themeluar me ligj dhe në të drejtën për ankim.

OSBE ka vërejtur në disa procese civile në të cilat gjykatat kanë dështuar që në mënyrë korrekte ta caktojnë vlerën e objektit të çështjes kontestuese. Kjo ndikon në të drejtën për gjykim nga tribunali i themeluar me ligj dhe në të drejtën për ankim.

KEDNJ garanto të drejtën për gjykim të drejtë para “tribunalit të pavarur dhe të paanshëm dhe themeluar me ligj”¹⁶. Në interpretimin e kësaj të drejte, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se gjykatat duhet të kenë përmbajtje të rregullt “në pajtim me ligjin” dhe ka vërejtur se ka shkelje atëherë kur ky tribunal nuk funksionon sipas të drejtës procedurale në fuqi¹⁷. Gjithashtu, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se e drejta për gjykim të drejtë, pjesë e rëndësishme e së cilës është e drejta e qasjes në gjykata, gjithashtu zbatohet edhe ë procedurën ankimore atëherë kur ligji vendor e parashikon të drejtën e ankesës¹⁸.

Në bazë të Ligjit mbi procedurën kontestimore (LPK),¹⁹ përbërja e trupit gjykues si dhe e drejta e ankesës para Gjykatës Supreme varet nga vlera e objektit të padisë. Ankimi para Gjykatës Supreme lejohet vetëm për disa raste të caktuara të kontesteve pronësore juridike dhe atëherë kur vlera e kontestit të shënuar në padi e kalon vlerën prej 818,07 EUR.²⁰ Në mënyrë të ngjashme, gjyqtari i vetëm i gjykon paditë pronësore juridike kur vlera e kontestit nuk e kalon shumën prej 818,07 EUR. Nëse vlera është më e madhe se

¹⁶ Neni 6(1), KEDNJ.

¹⁷ *Zand kundër Austrisë*, GJEDNJ, 7360/76, Raporti i komisionit, 12 tetor 1978, para. ---- .

¹⁸ *Tolstoy Miloslavski kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, 18139/91, aktgjykimi, 23 qershor 1995, para. 59.

¹⁹ Ligji mbi procedurën kontestimore (LPK), Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 27/90, dhe 35/91.

²⁰ Neni 382, i LPK; neni 2(i)(j), i Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2001/10 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 për valutën e lejuar për përdorim në Kosovë, 21 qershor 2001; dhe neni 3, i Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2001/24 mbi ndryshimin e Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 1999/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 për valutën e lejuar për përdorim në Kosovë, 21 qershor 2001.

kjo shumë, atëherë trupi gjykues duhet të përbëhet nga një gjyqtar dhe dy gjyqtarë porotë.²¹

Përcaktimi i vlerës së çështjes kontestuese parashikohet më hollësisht në nenet 35 deri 40 të LPK. Në përgjithësi, atëherë kur me padi kërkohet një shumë e caktuar e të hollave, kjo shumë është e rëndësishme për ta përcaktuar vlerën e objektit të kontestit, pa përfshirë kamatën, shpenzimet e gjykimit, dënimet e kontraktuara ose paditë tjera sekondare. Nëse me padi nuk kërkohet shuma e të hollave, atëherë vlera e objektit të kontestit shënohet nga paditësi në kërkesëpadi dhe ajo merret si relevante. Mirëpo, nëse “[në rast se paditësi e ka theksuar pa dyshim tepër larg ose shumë pak vlerën e objektit të kontestit kështu që shtrohet pyetja e përbërjes së gjykatës apo të drejtës së deklarimit të revizionit, gjykata, jo më vonë se në seancën përgatitore, e në qoftë se seanca përgatitore nuk është mbajtur atëherë në seancën kryesore para fillimit të shqyrtimit rreth çështjes kryesore, do ta verifikojë shpejtë e në mënyrë të përshtatshme saktësinë e vlerës së theksuar”²².

Përkundër këtyre dispozitave të qarta, OSBE ka vërejtur një numër kontestesh kur palët dhe gjykatat kanë dështuar ta caktojnë në mënyrë korrekte vlerën e objektit të kontestit.

Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

Në procedurën kontestimore të zhvilluar para Gjykatës Komunale në Prizren, me datë 9 maj 2007, paditësi ka kërkuar që t’i njihet e drejta e pronësisë mbi një tokë në sipërfaqe prej 64 ari dhe vlerën e objektit të kontestit e ka shënuar të jetë 25 EUR. Edhe pse vlera e pasurisë, pra edhe vlera e objektit të kontestit padyshim është më lartë se 25 EUR e sipas të gjitha gjasave edhe më e lartë se 818,07 EUR, gjykata nuk e ka vërtetuar saktësinë e vlerës së cituar në seancën përgatitore të datës 23 maj 2007. Të gjitha seancat e shqyrtimit kryesor²³ ishin mbajtur nga gjyqtari i vetëm.

Në procedurën kontestimore të zhvilluar para Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, e datës 26 dhjetor 2006, paditësi ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi pasurinë që e kishte blerë për 8.000 EUR. Mirëpo në kërkesëpadi vlera e objektit të kontestit ishte caktuar 250 EUR. Gjykata ka dështuar ta vërtetojë saktësinë e vlerës qysh në seancën e parë. Seancën e radhës të mbajtur më 21 shkurt 2007 e kishte mbajtur gjyqtari i vetëm²⁴.

Në padinë e ngritur para Gjykatës Komunale në Viti/Vitina, të datës 17 shtator 2002, paditësi ka kërkuar njohjen e të drejtës pronësore ndaj gjysmës së pasurisë të cilën e kishte blerë bashkëshorti i saj me çmim prej 40.000 DM. Përkundër

²¹ Nenet 42, 43, LCP; neni 2 (i) (a), Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2001/10, 21 qershor 2001, dhe neni 3, i Udhëzimit administrativ nr. 2001/24, 21 dhjetor 2001.

²² Neni 40, LPK.

²³ Seancat janë mbajtur me 7 dhe 19 qershor 2007.

²⁴ Shënim: në procesverbalin e kësaj seance është shënuar prania e gjyqtarëve porotë. Ngjashëm me këtë, prania e gjyqtarëve porotë ishte shënuar edhe në procesverbalin e seancës së parë të 11 janarit 2007.

kësaj vlere të lartë të kontestit, gjykata në aktgjykimin e datës 10 prill 2004 gabimisht e përcaktuar vlerën e objektit të kontestit të jetë 200 EUR, dhe e kishte aprovuar kërkesëpadinë. Ankesa e të pandehurit në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan/Gnjilane ishte refuzuar si të pabazuar. Më 18 tetor 2005, Gjykata Supreme e kishte refuzuar ankesën e të pandehurit për shkak se në kërkesëpadi ishte theksuar vlera e padisë vetëm 200 EUR duke u bazuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në të gjitha rastet, gjykata ka dështuar që në mënyrë korrekte ta caktojë vlerën e objektit të kontestit. Kjo jo vetëm që paraqet shkelje të ligjit vendor, por edhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në dy rastet e para, dështimi i gjykatave për ta vërtetuar saktësinë e padisë të paditurit lidhur me vlerën e objektit të kontestit, ka ndikuar në të drejtën e gjyqimit nga tribunali i themeluar me ligj. Në rastin e tretë, palët nuk kanë mundur ta ushtrojnë të drejtën e tyre për ankesë para Gjykatës Supreme ashtu si e parashikon LPK.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që:

- Gjykatat duhet ta vërtetojnë saktësinë e vlerës së objektit të kontestit të shënuar nga paditësi në kërkesëpadi dhe ta përcaktojnë vlerën duke u bazuar në ligj.
- Avokatët duhet ta respektojnë ligjin me rastin e shënimit të vlerës së objektit të kontestit në kërkesëpadi.